

Specialist/Sektori i Statistikës, Modeleve dhe Analizës së Indikatorëve, Drejtoria e Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike, Kontrollit dhe Zhvillimit Strategjik, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/Sektori i Statistikës, Modeleve dhe Analizës së Indikatorëve, Drejtoria e Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike, Kontrollit dhe Zhvillimit Strategjik, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Zbaton në nivel të lartë të gjitha detyrat e caktuara nga eprori dhe argumenton punën profesionale që ka kryer;
- Mbledh, analizon dhe përpunon në mënyrë të vazhdueshme informacione mbi zhvillimin e indikatorëve dhe statistikave të sigurisë kibernetike me qëllim identifikimin e trendeve, modeleve dhe kërcënimeve potenciale kibernetike;
- Analizon modelet dhe indikatorët e sigurisë kibernetike, për të identifikuar kërcënimet potenciale dhe rrezikun për sistemet kibernetike;
- Ndihmon në përgatitjen e planit të fushatave të ndërgjegjësimit dhe trajnimeve për ngritjen e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit;
- Harton shkresa, raporte, sipas nevojave të institucionit;
- Përshtat dhe publikon zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë kibernetike, në kanalet zyrtare të Autoritetit;
- Ndërvepron me sektorët e tjerë brenda Autoritetit për mbarëvajtjen e punës;
- Merr pjesë në grupet e punës për rritjen e kapaciteteve, që zhvillon Autoriteti me operatorët e infrastrukturave të informacionit dhe institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës "Master Profesional", në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Inxhinieri Elektrike/ Informatikë Ekonomike/ Shkenca Kompjuterike/Shkenca Shoqërore.

Përvoja: Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në fusha që lidhen me sigurinë kibernetike/teknologjinë e informacionit.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Legjislacionin e sigurisë kibernetike;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale.

Aftësi për të:

- Aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;
- Përbën avantazh pajisja me certifikata të fushës;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 31.08.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell shkualifikim të kandidatit.